

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Duke u mbështetur në traditën demokratike shekullore përparimtare e liridashëse të kombit shqiptar dhe të pjesëtarëve të nacionaliteteve të tjera të Republikës së Kosovës,

duke u mbështetur në luftërat çlirimtare dhe në luftën e përbashkët antifashiste, që të mbrojë qënien dhe pavarsinë e vetë si komb,

duke synuar sigurimin e mirëqënies së përgjithëshme të popullit, të humanitetit dhe të vendosjes së lirisë, barazisë dhe drejtësisë për vete dhe për breznitë që vijnë,

duke synuar një shoqëri demokratike me rritje të vazhdueshme të pasurisë së popullit, me arsim, shkencë e kulturë përparimtare, me një zhvillim të gjithanshëm të personalitetit të individit,

duke u nisur nga e drejta që populli të përcaktojë lirishtë, kurë dhe si ai dëshiron, pozitën e subjektivitetin e vetë politik dhe lirishtë të zbatojë të drejtën për zhvillim të vetë të pavarur ekonomik, shoqërorë e kulturor,

duke u nisur nga e drejta që lirishtë të disponojë me pasuritë e veta natyrore, me burimet dhe me mjetet vetjake për ekzistencë e zhvillim,

duke u nisur nga synimet për krijimin e shtetit juridik demokratik mbi bazat juridike e sociale mbi të cilat sigurohen e realizohen të drejtat nacionale, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit, drejtësia shoqërore, solidariteti, mirëqënia, përparimi individual e shoqërorë dhe dinjiteti i plotë i njeriut,

duke u siguruar të drejtat e plota pjesëtarve të nacionaliteteve të tjera që jetojnë në Republikën e Kosovës,

duke realizuar dëshirën që sipas vendimit të lirë vetjak të vazhdojë rrugën e demokracisë, të drejtësisë shoqërore, të paqës dhe të miqësisë midis popujve,

duke u nisur nga përcaktimi se vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror, vullnet të cilin ai e ka shprehur në mënyrë plebishitare për vetëpërcaktimin e subjektivitetit të tij politik-juridik,

duke garantuar të drejta të plota të njeriut dhe të qytetarit për te gjithë qytetarët,

Kombi shqiptar i Republikës së Kosovës në pajtim të plotë me parimet e demokracisë e të barazisë dhe në bazë të së drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje, dhe

duke u bazuar në DEKLARATËN E PAVARËSISË SË 2 korrikut 1990,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

NXJERR

KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Republika e Kosovës është shtet demokratik i Kombit shqiptar dhe i pjesëtarëve të kombeve të tjera dhe i pakicave kombëtare, të shtetasve të vetë; serbëve, muslimanëve, malazezëve, kroatëve, turqëve, romëve e të tjerëve që jetojnë në Kosovë.

Neni 2 *

Republika e Kosovës si shtet është antare e Bashkësisë së Jugosllavisë.

Neni 3

Sovraniteti në Republikën e Kosovës buron nga populli dhe i takon popullit.

Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror.

Neni 4

Sovraniteti i popullit realizohet përmes përfaqësuesve të zgjedhur në organet e pushtetit shtetëror dhe me referendum.

Neni 5

Të gjithë anëtarët e organeve përfaqësuese të pushtetit shtetëror i zgjedhin shtetasit e moshës madhore në bazë të të drejtës së votës së përgjithëshme, të barabartë, të drejtëpërdrejtë dhe të fshehtë, nga radha e më shumë kandidatëve.

Përfaqësuesit e zgjedhur të popullit në organet e pushtetit shtetëror janë përgjegjës para zgjedhësve të tyre.

Neni 6

Qytetarët si bartës të pushtetit kanë të drejtë të organizohen në parti politike, lidhje, lëvizje e shoqata të qytetarëve.

Neni 7

Çdo njeriu dhe qytetari i garantohen liritë dhe të drejtat politike, ekonomike, sociale, nacionale e kulturore dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Askujt nuk mund ti mohohet liria dhe e drejta për të marrë veprim në qoftë se veprimi nuk është i ndaluar shprehimisht me Kushtetutë dhe ligj.

* Dispozitat e nenit 2 dhe të neneve të tjera përkatëse do të harmonizohen varësisht nga përcaktimi i të gjitha njësive të tjera përkitazi me organizimin e ardhëshëm të Jugosllavisë

Neni 8

Teritori i Republikës së Kosovës është unik, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm.

Kufijtë e Republikës mund të ndryshohen vetëm në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me vullnetin e shprehur të popullit me të cilin ka të bëjë ndryshimi.

Neni 9

Qytetarët e Republikës së Kosovës gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Republikës. Shtetasit e njësive të tjera të Bashkësisë së Jugosllavisë gëzojnë liritë dhe të drejtat e përcaktuara me aktin e saj.

Neni 10

Organizimi teritorial i Republikës rregullohet me ligj.

Komuna dhe Qyteti janë formë e Bashkësisë teritoriale ku realizohen vetadministrimi lokal.

Neni 11

Në Republikën e Kosovës është në përdorim zyrtarë gjuha shqipe dhe shkrimi i saj.

Në rajonet e republikës së Kosovës ku jetojnë edhe pjesëtarët e nacionaliteteve tjera, në përdorim të barabart zyrtar janë edhe gjuha serbokroate e turke dhe shkrimet e tyre, në pajtim me ligjin.

Neni 12

Republika e Kosovës ushtron pushtetin shtetëror në mënyrë sovranë.

Të drejtat sovranë të Republikës së Kosovës, siguria e saj, si dhe rregullimi shoqëror - ekonomik e politik janë të mbrojtur me këtë Kushtetutë.

Neni 13

Pushteti kushtetutdhënës dhe ligjdhënës i takon Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe përcaktohen me këtë Kushtetutë.

Neni 14

Kryesia e Republikës së Kosovës është shëf kolegjal i shtetit.

Të drejtat e detyrat e Kryesisë përcaktohen me këtë Kushtetutë.

Neni 15

Organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv është Qeveria.

Të drejtat e detyrat e Qeverisë përcaktohen me këtë kushtetutë.

Neni 16

Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjyqet e pavarura.

Gjyqet punojnë vetëm në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 17

Gjyqi Kushtetues i Kosovës, si organ i pavarur i Republikës, mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.

Neni 18

Puna e organeve të pushtetit shtetëror është publike.

Puna publike e organeve të pushtetit shtetëror mund të përjashtohet vetëm në rastet e përcaktuara me ligj.

Neni 19

Republika ka stemën e vetë.

Përmbajtja dhe përdorimi i stemës përcaktohet me ligj.

Neni 20

Republika ka flamurin e vetë.

Përmbajtja dhe përdorimi i flamurit përcaktohet me ligj.

Neni 21

Republika ka himnin e vetë.

Përmbajtja dhe përdorimi i himnit përcaktohet me ligj.

Neni 22

Në Republikën e Kosovës është e drejtë e pjesëtarëve të kombeve dhe pakicave kombëtare që të përdorin simbolet e veta.

Kushtet dhe mënyra e përdorimit të simboleve të tyre rregullohen me ligj.

Neni 23

Kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina.

II. RENDI EKONOMIK DHE SOCIAL

Neni 24

Organizimi i jetës ekonomike dhe sociale rregullohet në mënyrën që të gjithë qytetarëve t'u sigurojë standard të jetesës në pajtim me drejtësinë, të bazuar në punën e tërësishme, si burim i mirëqënies, dhe në pajtim me dinjitetin njerëzor.

Është detyrë e shtetit të nxitë dhe realizojë, në pajtim me parimet demokratike, zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, me qëllim të ritjes së të ardhurave kombëtare dhe në këtë bazë edhe të mirëqënies ekonomike, sociale dhe kulturore të qytetarëve, por edhe të barazisë së tyre. Për këtë qëllim shteti merr përsipër të bëjë investime ku kërkon interesi shoqëror, veçmas në rajonet më pak të zhvilluara, si dhe të përgatisë planet e zhvillimit dhe ndërtimit harmonik të Republikës.

Në këto kufinj dhe baza sigurohet ekonomizimi i lirë i tregut, liria ndërmarëse dhe e bashkimit, pavarësia dhe barazia e subjekteve ekonomike në treg, si dhe iniciativa e lirë private ekonomike, duke i mundësuar secilit që me punën e vetë t'ia siguroj vetvetes ekzistencën adekuate.

Neni 25

Me ligj përcaktohet më hollësisht se veprimtaria ekonomike e lirë nuk mund të zhvillohet në kundërshtim me interesin shoqëror, ose në mënyrën që t'i shkaktojë dëme sigurisë, lirisë, barazisë dhe dinjitetit njerëzor. Me ligj përcaktohet mënyra sipas së cilës veprimtaria ekonomike publike dhe private drejtohet dhe koordinohet për qëllimet e shoqërisë. Në qarkullim ekonomik vlen parimi i marrëveshjes së lirë në pajtim me ligjin.

Neni 26

Garantohen të gjitha format e pronësisë.

Të gjitha format e pronësisë janë të barabarta dhe gëzojnë mbrojtje të njëjtë.

Bartës të së drejtës së pronësisë janë personat fizik dhe juridik.

Neni 27

Me ligj mund të përcaktohet shfrytëzimi dhe regjimi i pronësisë në pajtim me interesin e përgjithshëm.

Shpronësimi(eksproprijimi) lejohet vetëm për qëllime shoqërore të bazuara në ligj dhe vetëm në bazë të kompensimit që i përgjigjet vlerës së sendit në treg në ditën e shpalljes së aktit të shpronësimit.

Shpronësimi lejohet vetëm në qoftë se qëllimet e përgjithëshme shoqërore nuk mund të arrihen në mënyrë tjetër.

Kompensimin çdo herë e përcakton gjyqi civil.

Neni 28

Qytetarëve u garantohet e drejta e pronësisë në tokën bujqësore.

Me ligj përcaktohen kushtet dhe kufijtë në bazë të të cilave mund të fitohet e drejta e pronësisë në pyje dhe në tokën pyjore.

Neni 29

Pasuritë e natyrës dhe të mirat në përdorim të përgjithshëm, si dhe të mirat me interes të përgjithshëm, janë në pronësi shoqërore ose shtetërore. Me ligj mund të përcaktohen kushtet e fitimit të të drejtës së shfrytëzimit në pasuritë e natyrës dhe në të mirat në përdorim të përgjithshëm.

Neni 30

Mbrojtja e tokës, e pasurive të natyrës, e ujrave dhe e ajrit nga prishja dhe ndotja, është detyrë e shtetit, e organizatave ekonomike e shoqërore dhe e të gjithë qytetarëve.

Neni 31

Personi i huaj mund të fitojë të drejtën e pronësisë nën kushtet e përcaktuara me ligj.

Personit të huaj i garantohet e drejta që të veprojë e të organizojë veprimtari të pavarur, ose të investojë në ndërmarrjet e vendit ose të formojë ndërmarrje të përzier në kushtet e përcaktuara me ligj.

Neni 32

Me ligj rregullohet mbrojtja dhe zhvillimi i zejes.

Neni 33

Të gjitha pasuritë kulturore dhe historike, pa marrë parasysh në pronësinë e kujt janë, paraqesin pasuri të popullit. Ato janë nën mbrojtjen e shtetit dhe me ligj përcaktohen masat e ruajtjes së tyre.

Neni 34

Garantohet mbrojtja e punës intelektuale, e drejta e autorit, e shpikjes dhe e risimeve si dhe e artit e letërsisë.

Shkenca dhe kërkimet shkencore, si dhe zbatimi i njohurive të tyre, janë bazë qenësore e shoqërisë, të cilat shteti dhe shoqëria detyrohet t'i ndihmojë gjithanshëm.

Neni 35

E drejta e trashigimisë garantohet dhe rregullohet me ligj.

Neni 36

Qytetarët kanë të drejta në sigurim, pensionim dhe ndihmë në rast të paaftësisë për punë për shkak të sëmundjes, fatkeqësisë, amësisë, invaliditetit, moshës ose vdekjes, në rastin e ngritjes së fëmijës si dhe për ndihmat për rastet e përcaktuara me ligj.

Shteti u siguron qytetarëve shërbimin e nevojshëm mjeksor në qendrat shëndetsore në Republikë.

Neni 37

Çdo fëmijë, sipas pozitës së tij të mitur, pa dallim race, gjinie, gjuhe, besimi, të prejdardhjes nacionale ose sociale, të pasurisë ose lindjes, ka të drejta në masat mbrojtëse nga ana e familjes, e shoqërisë dhe e shtetit.

Neni 38

Personat e mitur, personat e paaftë për punë dhe të moshuarit, që nuk kanë të afërm, ose që kanë ngelur pa kujdesin e të afërmeve të vetë, gjenden në mbrojtje të veçantë të shtetit.

Neni 39

Çdo qytetar ka të drejtë në vendosje adekuate banimi. Me ligj përcaktohet vendosja higjenike dhe ekonomike me anë të masave të drejtuara në lehtësimin e shfrytëzimit e të fitimit të pronësisë dhe të nxitjes së investimit të kapitalit privat për këtë qëllim.

Neni 40

Mjetet për realizimin e të drejtave të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë dhe ligj nga lëmi i shëndetësisë, i mbrojtjes sociale dhe të fëmijve dhe të formave të tjera të sigurimit social, të arsimit, të shkencës, të kulturës, të kulturës fizike, si dhe në lëmitë e tjera të përcaktuara me ligj, sigurohen me bugjet.

Mjetet për realizimin e të drejtave të të zënëve me punë në bazë të sigurimit të detyrueshëm social (shëndetsor, pensional, invalidor e të tjerë), i sigurojnë të zënë me punë dhe punëdhënësit në pajtim me ligjin.

Neni 41

Me ligj mundë të përcaktohen veprimtaritë që kanë vetitë e shërbimeve publike dhe përcaktohet mënyra e ushtrimit të tyre.

III. LIRITË, TË DREJTAT DHE DETYRAT E NJERIUT DHE TË QYTETARIT

Neni 42

Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit janë të kufizuara vetëm me liritë dhe të drejtat e barabarta të të tjerëve.

Neni 43

Qytetarët janë të barabartë në të drejta dhe detyra dhe gëzojnë mbrojtje të njëjtë para organeve shtetërore dhe organeve të tjera, pa dallim kombësie, race, gjinie, feje, bindje politike dhe bindje tjetër, arsimi, prejardhjeje sociale, gjendje materiale ose vetie tjetër personale.

Neni 44

Jeta e njeriut është e pacënueshme.

Dënimi me vdekje mundë të përcaktohet me ligj dhe shqiptohet përjashtimisht vetëm për format më të rënda të veprave të rënda penale.

Neni 45

Liria e njeriut është e pacënueshme.

Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveç në rastet dhe në procedurën e përcaktuar me ligj, në bazë të vendimit të gjyqit kompetent.

Heqja e kundërligjshme e lirisë dënohet.

Neni 46

Personi, për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale, mund të vihet në paraburgim dhe të mbahet në paraburgim vetëm kur kjo është e domosdoshme për zbatimin e procedurës penale ose për sigurinë e njerëzve. Paraburgimi caktohet me vendim të gjyqit, e vetëm në raste të jashtëzakonshme, në kushtet e caktuara me ligj, me vendim të organit tjetër të autorizuar me ligj- më së shumti deri në tri ditë.

Personit që është vënë në paraburgim duhet t'i dorëzohet vendimi me shkrim, i arsyetuar, në momentin e paraburgimit. Kundër këtij vendimi ky person ka të drejtë ankese mbi të cilën gjyqi vendos brenda afatit prej 48 orësh.

Koha e paraburgimit duhet të reduktohet në masën më të vogël të domosdoshme.

Paraburgimi sipas vendimit të shkallës së parë mund të zgjasë më së shumti tre muaj nga dita e vënies në paraburgim. Ky afat me vendim të Gjyqit Suprem mund të zgjatet edhe

tre muaj. Në qoftë se deri në kalimin e këtyre afateve nuk ngritet padia, i pandehuri lirohet.

Neni 47

Qytetarëve u garantohet liria e qarkullimit dhe e banimit dhe e drejta që të largohen nga vendi dhe që të kthehen në të.

Liria e qarkullimit dhe e banimit mund të kufizohen vetëm me ligj, nëse këtë e kërkon zhvillimi i procedurës penale, parandalimi i sëmundjeve ngjitëse ose interesat e mbrojtjes së vendit.

Neni 48

Dinjiteti i njeriut dhe jeta e tij private janë të pacenueshme.

Neni 49

Qytetarëve u garantohet liria e punës, zgjedhja e lirë e profesionit dhe e punës dhe e drejta, në kushtet e njejta, për çdo vend pune dhe funksion.

Ndalohet puna me dhunë.

Neni 50

Punëtori ka të drejtë për kushtet e punës që i sigurojnë integritetin dhe sigurinë fizike dhe morale të tij.

Neni 51

Të zënë me punë, në mënyrën e përcaktuar me ligjin dhe kontratën kolektive, kanë të drejtë në kompensim adekuat për punë.

Neni 52

Të zënë me punë kanë të drejtë në grevë, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 53

Në pajtim me ligjin, të zënë me punë kanë të drejtë në kohë të kufizuar të punës prej 42 orëve në javë, në pushim ditor dhe javor dhe në pushim vjetor me pagesë.

Neni 54

Qytetarët të cilët nuk janë plotësisht të aftë për punë u garantoheft aftësimi për punë gjegjëse dhe krijohen kushtet për punësimin e tyre, në pajtim me ligjin.

Në kushtet e përcaktuara me ligj, garantoheft e drejta në sigurinë materiale gjatë kohës së papunësisë së përkohëshme.

Neni 55

Qytetari që i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet ka të drejtë të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur.

Në zgjedhje marin pjesë partitë politike, lëvizjet, lidhjet e shoqatat, të cilat formohen e veprojnë lirisht, si dhe grupet e qytetarëve. Ato duhet të respektojnë parimin e sovranitetit popullor e të demokracisë dhe t'u përmbahen kufinjëve të aktivitetit të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj.

Neni 56

Garantoheft liria e bashkimit, e mbledhjes dhe e tubimit publik të qytetarëve, si dhe liria e organizimit dhe aktivitetit politik dhe sindikal, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Të zënë me punë, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të veta, mund të organizojnë aktivitete sindikale dhe të anëtarësohen në to sipas vullnetit.

Ndalohet organizimi dhe aktiviteti politik i drejtuar në ndryshimin me dhunë të rregullimit të përcaktuar me Kushtetutë dhe cënimin e tërësisë teritoriale e të pavarësisë së Bashkësisë së Jugosllavisë e të Republikës, nxitjes së urrejtjes dhe mosdurimit nacional, racor e fetar. Mënyra e realizimit të lirisë së organizimit dhe të aktivitetit politik e sindikal rregullohet me ligj.

Neni 57

Fshehtësia e letrave dhe e mjeteve të tjera të komunikimit është e pacënueshme.

Me ligj mund të përcaktohet që vetëm në bazë të vendimit të gjyqit mundë të bëhet përjashtim nga parimi i pacënueshmërisë së fshehtësisë së letrave dhe të mjeteve të tjera të komunikimit, po qe se kjo është e domosdoshme për zhvillimin e procedurës penale ose për sigurinë e vendit.

Neni 58

Garantohet mbrojtja e të dhënave personale.

Mbledhja, përpunimi dhe shfrytëzimi i të dhënave personale rregullohet me ligj.

Neni 59

Banesa është e paprekëshme.

Me ligj mund të përcaktohet që personi zyrtar vetëm në bazë të vendimit të gjyqit mund të hyjë në banesë ose në lokalet e tjera kundër vullnetit të mbajtësit të tyre dhe në to të bëjë bastisje.

Bastisja mund të bëhet vetëm në praninë e dy dëshmitarëve.

Në kushtet e përcaktuara me ligj, personi zyrtar mund të hyjë në banesë ose në lokale pa vendimin e gjyqit dhe të bëjë bastisjen nëse kjo është e domosdoshme për të zënë drejtëpërsëdrejt kryesinë e veprës penale ose për të shpëtuar njerëzit dhe pasurinë.

Neni 60

Secili ka të drejtë për mbrojtjen e barabartë të të drejtave të veta në procedurë para gjyqit, organeve shtetërore dhe organeve e organizatave të tjera, që vendosin mbi të drejtat, obligimet dhe interesat e tij.

Secilit i garantohet e drejta e ankesës, ose e mjetit tjetër juridik kundër vendimeve të gjyqit, të organeve shtetërore dhe të organeve e organizatave

të tjera, me të cilat vendoset mbi të drejtën ose interesin e tij të bazuar në ligj.

Neni 61

Askush nuk mund të dënohet për vepër e cila, para se të kryhet, nuk ka qenë e parashikuar me ligj ose me dispozitë të bazuar në ligj si vepër e dënueshme, e as të shqiptohet dënimi që nuk ka qenë i paraparë për atë vepër.

Veprat penale dhe sanksionet penale mund të caktohen vetëm me ligj.

Sanksionet penale i shqyrton gjyqi kompetent sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Askush nuk mund të konsiderohet fajtor për vepër penale për derisa kjo të mos vërtetohet me aktgjykim gjyqësor të formës së prerë. Personi që është dënuar pa arsye për vepër penale ose i cili pa bazë është privuar nga liria, ka të drejtë për rehabilitim dhe për shpërblimin e dëmit nga mjetet shtetërore, si dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 62

Secilit i garantohet e drejta për mbrojtje para gjyqit. Askush që nxirret para gjyqit ose organit tjetër kompetent për zhvillimin e procedurës, nuk mund të dënohet në qoftë se sipas ligjit nuk është marrë në pyetje ose nuk i është dhënë mundësi që të mbrohet.

I pandehuri ka të drejtë të marrë mbrojtësin të cilit, në pajtim me ligjin, i bëhet e mundur mbrojtja dhe sigurimi i të drejtave dhe i interesave të të pandehurit.

Me ligj përcaktohet se në cilat raste i pandehuri medoemos duhet të ketë mbrojtësin.

Neni 63

Qytetari, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, ka të drejtë të kërkojë zhdëmtim nga shteti, për dëmin që i shkaktohet nga veprimet e paligjshme të organeve shtetërore gjatë ushtrimit të detyrës, ose nga organizata që ushtron autorizime publike.

Neni 64

Garantohet respektimi i personalitetit të njeriut dhe i dinjitetit njerëzor në procedurën penale dhe në çdo procedurë tjetër, në rast heqjeje, respektivisht kufizimi të lirisë, si dhe gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit.

Garantohet pacënueshmëria e integritetit të personalitetit të njeriut, të jetës personale dhe familjare, si dhe të drejtat e tjera personale.

Ndalohet dhe është i dëmshëm çdo detyrim për të pranuar dhe për t'u deklaruar.

Ndaj askujt nuk mund të zbatohen mundime apo ndëshkime, respektivisht sjellje nënçmuese. Posaçërisht është e ndaluar që ndaj ndokujt, pa lejen e tij, të bëhen eksperimente medicinale ose eksperimente të tjera shkencore.

Neni 65

Është e drejtë e njeriut që të vendosë lirisht për lindjen e fëmijes.

Neni 66

Familja gëzon mbrojtje të posaçme ligjore.

Nëna dhe fëmija gëzojnë mbrojtje të posaçme.

Martesa dhe marrëdhëniet juridike në martesë e në familje rregullohen me ligj.

Neni 67

Është i obligueshëm shkollimi fillor që zgjat së paku tetë vjet.

Qytetarët kanë të drejtë që, në kushte të barabarta të përcaktuara me ligj, të fitojnë dije dhe përgatitje profesionale në të gjitha shkallët e arsimit.

Në shkollat që financohen nga të ardhurat publike shkollimi është pa pagesë.

Neni 68

Në shkollat fillore, të mesme, të larta e fakultete, respektivisht në paralelet e tyre sigurohen kushtet për mësimin në gjuhën amëtare, respektivisht në gjuhën shqipe, sërbo-kroate dhe turke, në pajtim me ligjin.

Në rajonet ku jetojnë romët, varësisht nga kushtet, sigurohet mësimi fillor edhe në gjuhën rome.

Neni 69

Garantohet liria e krijimit dhe e publikimit shkencor, profesional dhe artistik si dhe e krijimeve të tjera kulturore.

Neni 70

Garantohet liria e mendimit dhe e shprehjes publike të mendimit.

Neni 71

Garantohet liria e shtypit dhe e formave të tjera të informimit publik.

Qytetarët kanë të drejtë që në mjetet e informimit publik të botojnë mendimet e veta. Qytetarët, organet shtetërore, partitë politike, lidhjet, lëvizjet, e qytetarve, në kushtet e caktuara me ligj, mund të botojnë shtypin dhe të përhapin informata me anë të mjeteve të tjera të informimit.

Me ligj dënohet cenzura dhe çdo masë tjetër preventive që e cenon lirinë e shtypit dhe format e tjera të informimit publik.

Neni 72

Qytetari ka të drejtë të kritikojë publikisht punën e organit shtetëror, partisë politike, lidhjes, lëvizjes ose shoqatës së qytetarëve dhe të bartësve të autorizimeve publike si dhe që t'u paraqesë parashtrës, peticione, propozime e inisiativa dhe që për to të marrë përgjigje.

Neni 73

Shtetasi i Republikës së Kosovës në botën e jashtme gëzon mbrojtjen e Republikës së vet.

Shtetasi i Republikës së Kosovës nuk mund të zhvishet nga shtetësia, të largohet nga vendi, e as të ekstradohet.

Shtetasit të Republikës së Kosovës, i cili nuk gjendet në vend, e i cili disponon me shtetësi tjetër, mundet që vetëm përjashtimisht, në bazë të ligjit, t'i merret shtetësia, në qoftë se me punën e vetë u shkakton dëm interesave ndërkombëtare ose interesave të tjera të Republikës së Kosovës ose në qoftë se refuzon të kryej obligimet qytetare.

Neni 74

U garantohet e drejta e strehimit shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, të cilët ndiqen për shkak të angazhimit të tyre për pikpamje dhe lëvizje demokratike, për çlirimin social dhe nacional, për lirinë dhe të drejtat e personalitetit të njeriut ose për lirinë e krijimit shkencor ose artistik.

Neni 75

Qytetarit i garantohet liria e shprehjes së përkatësisë kombëtare, liria e shprehjes së kulturës kombëtare dhe liria e përdorimit të gjuhës e të shkrimit të saj.

Qytetari nuk është i detyruar të deklarohet se cilës përkatësi kombëtare i takon, as të përcaktohet që t'i takojë njërit nga kombet, respektivisht pakicës kombëtare.

Është kundërkushtetuese dhe dënohet çdo propagim ose zbatim i pabarazisë kombëtare, si dhe çdo mbjellje e urrejtjes dhe mosdurimit kombëtar, racial ose fetar, mohimi i historisë, kulturës dhe i vlerave të tjera kombëtare.

Neni 76

Garantohet liria e ndërgjegjes, besimit fetar dhe e manifestimit të fesë.

Bashkësitë fetare janë të ndara nga shteti dhe janë të lira në kryerjen e punëve fetare dhe të ceremonive fetare.

Bashkësitë fetare mund të hapin shkolla fetare dhe ente bamirëse.

Neni 77

Mbrojtja e vendit është e drejtë e pacënueshme dhe e patjetërsueshme dhe obligim dhe nder i madh i çdo qytetari.

Neni 78

Është detyrë e secilit t'i jap ndihmë tjetrit në rrezik dhe të marrë pjesë në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm.

Neni 79

Liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë nuk mund të merren e as të kufizohen.

Liritë dhe të drejtat realizohen, ndërsa detyrimet përmbushen në bazë të Kushtetutës.

Me ligj mund të caktohet vetëm mënyra e realizimit të disa lirive dhe të drejtave kur kjo është e përcaktuar me Kushtetutë ose kur kjo është e domosdoshme për realizimin e tyre.

Sigurohet mbrojtja gjyqësore e lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

IV. KUSHTETUTSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA

Neni 80

Përkujdesja për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë është obligim i të gjithëve dhe i secilit.

Neni 81

Ligjet, dispozitat dhe aktet e tjera duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën.

Dispozitat dhe aktet e tjera të organeve republikane duhet të jenë në pajtim me ligje.

Dispozitat dhe aktet e tjera nuk mund të jenë në kundërshtim me ligjin dhe me dispozitat e tjera republikane.

Neni 82

Ligjet, dispozitat dhe aktet e tjera hyjnë në fuqi jo më parë se ditën e tetë pas shpalljes, në qoftë se për shkaqe posaçërisht të arsyeshme nuk është parashikuar që të hyjnë në fuqi në afat më të shkurtër.

Ligjet, dispozitat dhe aktet e tjera të organeve republikane, komunale e të qytetit shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës".

Neni 83

Ligjet, dispozitat dhe aktet e tjera nuk mund të kenë efekt prapaveprues.

Vetëm me ligj mund të caktohet që disa dispozita të tij, nëse këtë e kërkon interesi i përgjithshëm, të kenë efekt prapaveprues.

Veprat e dënueshme përcaktohen dhe dënimet për këto vepra shqiptohen sipas ligjit, përkatësisht dispozitës tjetër që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës, përveç nëse ligji, përkatësisht dispozita e re është më e butë për kryesin.

Neni 84

Organet shtetërore dhe organizatat që ushtrojnë autorizime publike, në çështjet individuale mund të vendosin mbi të drejtat dhe detyrat ose, në bazë të ligjit, të aplikojnë masa detyrimi ose kufizimi, vetëm në procedurën e përcaktuar me ligj në të cilën i jipet mundësia secilit që ti mbrojë të drejtat e interesat e veta dhe që kundër aktit të nxjerrë të paraqesë ankesë ose të përsërisë mjetin tjetër juridik të parashikuar me ligj.

Neni 85

Kundër vendimeve dhe akteve të tjera individuale të organeve gjyqësore, administrative dhe të organeve të tjera shtetërore, si dhe kundër akteve të këtilla të organeve dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike të nxjerra në shkallën e parë, mund t'i paraqitet ankesa organit kompetent.

Në rastet e jashtëzakonshme dhe të caktuara me ligj mundë të përjashtohet ankesa, po qe se në mënyrë tjetër është sigurua mbrojtja e të drejtave dhe e ligjëshmërisë.

Mbi ligjshmërinë e akteve individuale përfundimtare, në të cilat organet shtetërore ose organizatat që ushtrojnë autorizime publike vendosin mbi të drejtat ose obligimet, vendos gjyqi në konfliktin administrativ, po qe se për çështjen e caktuar nuk është parashikuar me ligj mbrojtja tjetër gjyqësore.

Vetëm me ligj për llojet e caktuara të çështjeve administrative, mund të përjashtohet konflikti administrativ.

Neni 86

Mosnjohja e gjuhës në të cilën zhvillohet procedura nuk mund të jetë pengesë për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe interesave të qytetarëve.

Secilit i garantohet e drejta që në procedurën para gjyqit, organeve të tjera shtetërore, të organeve dhe organizatave që në ushtrimin e autorizimeve publike vendosin mbi të drejtat dhe obligimet e njerëzve e të qytetarëve, të përdorë gjuhën e vet dhe që, në këtë procedurë të njihet në gjuhën e vetë me faktet.

V. ORGANIZIMI TERITORIAL I REPUBLIKËS

Komuna dhe Qyteti

Neni 87

Komuna është njësi teritoriale në të cilën qytetarët realizojnë vetadministrimin, në harmoni me statutin e komunës.

Republika me ligj mund ti besojë kryerjen e disa punëve komunës.

Neni 88

Komuna në bazë dhe në suaza të Kushtetutës dhe të ligjit nëpërmjet organeve të veta:

1. miraton programin e zhvillimit, planin urbanistik, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare;
2. siguron zhvillimin e veprimtarive komunale dhe me dispozitat e veta rregullon kushtet e përgjithshme për kryerjen e tyre;
3. përkujdeset për ndërtimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e rrugëve lokale dhe rrugicave si dhe të objekteve të tjera publike me interes komunal;
4. rregullon shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe të hapsirës afariste;
5. përkujdeset për përmbushjen e nevojave të qytetarëve në lëmin e kulturës, arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe të fëmijve, të kulturës fizike, zejtarisë, turizmit dhe të hotelërisë, të mbrojtjes e përparimit të mjedisit jetësor dhe në sferat e tjera me interesa të drejtëpërdrejt për qytetarët;
6. siguron zbatimin e dispozitave komunale, si dhe ligjeve dhe dispozitave të tjera republikane, realizimi i të cilave i është besuar komunës dhe
7. formon organe, organizata dhe shërbime të komunës.

Komunës i takojnë të hyrat e përcaktuara me ligj.

Mjetet për përmbushjen e nevojave të qytetarëve mund të sigurohen edhe me vetëkontribut, në pajtim me ligjin. Për zbatimin e vetëkontributit qytetarët vendosin me referendum.

Neni 89

Komuna ka statutin me të cilin rregullohen funksionet e komunës, organizimi dhe puna e organeve komunale, si dhe çështjet e tjera me interes për komunën.

Statutin e nxjerr kuvendi i komunës.

Neni 90

Për punët e komunës qytetarët vendosin me referendum dhe nëpërmjet deputetëve në kuvendin e komunës.

Kuvendin e komunës e përbëjnë deputet të zgjedhur në zgjedhjet e lira, të drejtëpërdrejta, me vota të fshehta.

Neni 91

Me ligj mund të përcaktohet se komuna ka statusin e Qytetit.

Me ligj përcaktohen punët, të cilat Republika ia beson Qytetit.

Neni 92

Qyteti i Prishtinës është njësi e posaçme teritoriale.

Qyteti ka statutin me të cilin rregullohen funksionet e qytetit, organizimi dhe puna e organeve të qytetit, si dhe çështje të tjera me interes për qytetin.

Statutin e Qytetit e nxjerr Kuvendi i Qytetit.

Kuvendin e Qytetit e përbëjnë deputetët e zgjedhur në zgjedhjet e lira, të drejtëpërdrejta, me vota të fshehta.

Qyteti i Prishtinës kryen punët e komunës të përcaktuar me Kushtetutë, të cilat janë me interes për Qytetin e Prishtinës si tërësi.

Me ligj, në kompetencë të qytetit, mund të barten disa të drejta dhe obligime të Republikës.

VI. TË DREJTAT DHE DETYRAT E REPUBLIKËS

Neni 93

Të drejtat dhe detyrat e Republikës i ushtrojnë organet republikane të caktuara me Kushtetutë.

Liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit, barazia përpara ligjit, pavarësia dhe pozita e barabartë e të gjithë subjekteve të ekonomizimit, janë bazë dhe suazë e autorizimeve dhe e përgjegjësisë së organeve republikane.

Neni 94

Organet republikane, në kuadër të të drejtave e të detyrave të Republikës, të përcaktuara me ligj, përcaktojnë politikën, miratojnë e zbatojnë ligjin dhe dispozitat dhe aktet e tjera, ushtrojnë mbrojtjen kushtetuese- gjyqësore dhe atë gjyqësore të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Organeve të tjera në Republikë mund t'u besohet zbatimi i ligjeve dhe i dispozitave të tjera si dhe i akteve të tjera nga suazat e të drejtave e të detyrave të Republikës, me kusht që organet republikane të jenë përgjegjës për kryerjen e këtyre punëve.

Neni 95

Republika realizon dhe siguron:

1. sovranitetin, pavarësinë dhe tërësinë teritoriale të Republikës dhe pozitën ndërkombëtare e marrëdhëniet e Republikës me shtetet e tjera dhe me organizatat e ndryshme ndërkombëtare;
2. liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit dhe kushtetutshmërinë e ligjshmërinë;
3. mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e sistemit të përcaktuar me Kushtetutë;
4. të drejtat sendore dhe detyrimet, pozitën juridike të subjekteve të ekonomizimit, sistemin në sferat e financave, të marrëdhënieve ekonomike me botën e jashtme, të tregut, të planifikimit, të marrëdhënieve të punës, të mbrojtjes në punë, të sigurimit social dhe format e tjera të sigurisë sociale dhe qështjet e tjera në sferën e marrëdhënieve ekonomike, sociale me interes të përgjithshëm;
5. sistemin e shëndetësisë, të mbrojtjes sociale e të fëmijëve, të arsimit, të shkencës, të kulturës e të kulturës fizike, informimit shoqëror e publik;
6. kontrollin e ligjshmërisë lidhur me disponimin e mjeteve të personit juridik, revizionin financiar të të dalurave publike dhe mënyrën e organizimit të këtyre punëve;
7. qëllimet themelore dhe drejtimit e zhvillimit ekonomik, demografik, rajonal e social, organizimin dhe shfrytëzimin e hapsirës, mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor, politikën dhe masat për orientimin dhe nxitjen e zhvillimit, duke përfshirë edhe zhvillimin e rajoneve më pak të zhvilluara, rezervat e mallrave;
8. financimin e ushtrimeve të funksioneve të Republikës të përcaktuara me Kushtetutë e me ligj;
9. organizimin, kompetencën dhe punën e organeve shtetërore;
10. punët e tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

VII. ORGANET REPUBLIKANE

I. KUVENDI I REPUBLIKËS

Neni 96

Kuvendi i Republikës është organ i pushtetit ligjdhënës.

Neni 97

KUVENDI I REPUBLIKËS:

- 1.vendos për nxjerrjen dhe ndryshimin e Kushtetutës së Republikës, si dhe jep pëlqimin mbi aktin më të lartë të bashkësisë së Jugosllavisë;
- 2.përcakton politikën, nxjerr ligje dhe dispozita të tjera si dhe akte të përgjithshme;
3. miraton planin e zhvillimit, planin hapësinor, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare;
4. vendos për ndryshimin e kufijve të Republikës;
5. përcakton organizimin teritorial të Republikës;
- 6.vendos për luftën dhe paqën;
7. ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare;
8. shpall referendumin republikan;
9. shpall huat publike republikane dhe vendos për hyrjen borxh të Republikës;
10. zgjedh dhe shkarkon: kryetarin dhe nënkryetarin e Kuvendit të Republikës, kryetarin, nënkryetarin dhe ministrat në Qeverinë e Republikës,

kryetarin dhe gjyqtarët e Gjyqit Kushtetues, Gjyqit Suprem dhe të gjyqeve të regullta në Republikë, prokurorin publik republikan dhe prokurorët publik në Republikë dhe bartësit e tjerë të funksioneve publike të caktuara me ligj;

11. bënë kontrollin e punës së Qeverisë dhe të organeve të tjera, si dhe bartësve të funksioneve publike që janë përgjegjës përpara Kuvendit të Republikës, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;

12. shpall zgjedhjet e parakohëshme për kuvendet e komunave dhe të Qytetit në rastet kur konstaton se është bërë shkelje e rëndë e Kushtetutës dhe e ligjit, si dhe kur janë cënuar të drejtat e qytetarëve dhe të nacionaliteteve;

13. amnistion kryesit e veprave penale;

14. shpall ligjet;

15. jep interpretime autentike të ligjeve;

16. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Neni 98

Kuvendi i Republikës përbëhet nga një dhomë dhe ka 130 deputetë.

Deputetët zgjedhen në zgjedhjet e lira, të drejtëpërdrejta, me vota të fshehta.

Kandidatët për deputetë mund t'i propozojnë: partitë politike, lëvizjet, lidhjet, shoqatat dhe grupet e qytetarëve.

Mënyra e zgjedhjes dhe e revokimit të deputetëve dhe formimi i njësive zgjedhore rregullohen me ligj.

Neni 99

Deputeti përfaqëson qytetarët e njësisë zgjedhore në të cilën zgjedhet.

Deputeti është përgjegjës para zgjedhësve të njësisë zgjedhore.

Neni 100

Deputeti gëzon imunitet.

Deputeti nuk mund të thirret në përgjegjësi penale, të arrestohet apo të dënohet për mendimin e shprehur ose për dhënien e votës në Kuvendin e Republikës.

Deputeti nuk mund të arrestohet pa lejen e Kuvendit të Republikës, e në qoftë se thirret në imunitet, kundër tij nuk mund të inicohet procedura penale pa lejen e Kuvendit të Republikës.

Deputeti mund të arrestohet pa lejen e Kuvendit të Republikës vetëm në qoftë se është zënë në kryerjen e veprës për të cilën është përcaktuar dënimi me burg në kohëzgjatje më tepër se pesë vjetë.

Kuvendi i Republikës mund të vendosë që të zbatohet imuniteti ndaj deputetit i cili nuk është thirrë në imunitet në qoftë se kjo është e nevojshme për kryerjen e funksionit të tij.

Neni 101

Deputetët zgjedhen për katër vjet.Po për këtë periudhë zgjedhet edhe kryetari dhe nënkryetari i Kuvendit të Kosovës.

Ditën e verifikimit të mandatit të deputetëve të rij pushon funksioni i deputetëve,mandati i të cilëve kalon.

Kuvendi i Republikës, në rast rreziku të drejtëpërdrejtë nga lufta, ose në rast të gjendjes së luftës, vendos mbi zgjatjen e mandatit të deputetëve të Republikës, si dhe mbi zgjatjen e mandatit të deputetëve në kuvendet e komunave dhe të qytetit.

Neni 102

Kuvendi i Republikës mban mbledhje të rregullta.

Mbledhja e Kuvendit mund të thirret edhe me kërkesë të Kryesisë së Republikës, të Qeverisë së Republikës, ose të më së paku 30 deputetëve me rend dite të përcaktuar më parë.

Kuvendi i Republikës vendos në mbledhjen në të cilën merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve.Kuvendi merr vendime me shumicë votash, në qoftë se me Kushtetutë nuk është parashikuar shumica e posaçme.

Të drejtën e propozimit të ligjeve dhe të dispozitave të tjera e kanë Qeveria, çdo deputet dhe më së paku 20.000 qytetar-bartës të të drejtës zgjedhore.

Neni 103

Kryetari i Kuvendit të Republikës, e në mungesë të tij, nënkryetari i Kuvendit, përfaqëson Kuvendin, thërret mbledhjet e Kuvendit, nënshkruan aktet që i nxjerr Kuvendi dhe shpall me dekret ligjet republikane, si dhe shpall zgjedhjet.

Neni 104

Për shqyrtimin e propozimit të ligjeve dhe të akteve të tjera dhe përcjelljen e realizimit të tyre, Kuvendi mund të formojë forume punuese të përhershme dhe të përkohëshme.

Në Kuvend formohet Komisioni për liritë dhe të drejtat e qytetarëve si dhe barazinë nacionale.

Neni 105

Kuvendi i Republikës mund të vendosë që, për disa çështje nga kompetenca e tij, qytetarët të vendosin në referendum republikan.

Neni 106

Puna e Kuvendit të Republikës dhe e forumeve punuese, organizimi i tyre i brendshëm dhe të drejtat e detyrat e deputetëve rregullohen me Regulloren e punës.

2. KRYESIA E REPUBLIKËS

Neni 107

Kryesia e Republikës së Kosovës përfaqëson Republikën.

Neni 108

Kryesia e Republikës:

1. vendos mbi çështjet nga sfera e mbrojtjes popullore, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin dhe udhëheq rezistencën popullore në luftë;
2. miraton dekrete me fuqi ligjore, në rast të rrezikut të drejtëpërdrejtë nga lufta, gjatë kohës së gjendjes së luftës, rrezikimit të pavarësisë nacionale, ose të tërësisë territoriale dhe pamundësisë së funksionimit të rregullt të organeve republikane në qoftë se Kuvendi i Republikës nuk ka mundësi të mbajë mbledhje. Me dekrete me fuqi ligjore mund të suprimohen disa dispozita të Kushtetutës që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e qytetarëve dhe me organizimin, përbërjen dhe autorizimet e disa organeve republikane. Dekretet me fuqi ligjore Kryesia e Republikës ia paraqet Kuvendit të Republikës për verifikim menjëherë posa ai të ketë mundësi të mblidhet;
3. përcakton planet dhe masat për mbrojtjen e vendit, jepë udhëzime për marrjen e masave për përgatitjen dhe mobilizimin e burimeve dhe forcave të vendit për mbrojtje dhe për kordinimin e planeve dhe të masave të subjekteve të tjera, përcakton ekzistimin e rrezikut të drejtëpërdrejt nga lufta, urdhëron mobilizimin e përgjithshëm dhe të pjesërishëm dhe, në qoftë se Kuvendi i Republikës nuk ka mundësi që të mbajë mbledhje, shpall gjendjen e luftës;
4. përcakton planin e përdorimit të forcave të armatosura në rast lufte dhe urdhëron përdorimin e forcave të armatosura në paqë;
5. vendos mbi çështjet nga sfera e politikës së jashtme dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;
6. në marrëveshje me partitë politike, i propozon Kuvendit të Republikës kandidatin për kryetar të Qeverisë;
7. i propozon Kuvendit të Republikës kandidatët për kryetar dhe gjyqëtar të Gjyqit Kushtetues;
8. shqyrton dhe i propozon Kuvendit të Republikës dhe Qeverisë shqyrtimin e çështjeve me interes të përgjithshëm për Republikën;
9. u fal dënimin kryesive të veprave penale;
10. jep dekorata e mirënjohje të përcaktuara me ligj;
11. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Neni 109

Kryesia e Republikës ka kryetarin dhe gjashtë anëtarë të cilët i zgjedhin qytetarët e Republikës në zgjedhjet e lira, të drejtëpërdrejta, me vota të fshehta në pajtim me ligjin.

Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të Kryesisë së Republikës zgjat katër vjetë.

I njëjti person mund të zgjedhet në këtë detyrë më së shumti dy herë.

Në rast reziku të drejtëpërdrejtë nga lufta ose në rast të gjendjes së luftës, me vendimin e Kryesisë, mandati i anëtarëve të Kryesisë së Republikës mund të zgjatet deri sa të zgjatë gjendja e këtillë.

Kryetari dhe anëtarët e Kryesisë së Republikës nuk mund të kryejnë funksion tjetër publik.

Kryetari dhe anëtarët e Kryesisë së Republikës gëzojnë imunitet sikurse deputetët.

Neni 110

Kryesia e Republikës vendos me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kryesisë.

Kryetari i Kryesisë përfaqëson Kryesinë, thëret mbledhjet e Kryesisë dhe i kryeson, nënshkruan aktet që i nxjerr Kryesia dhe kujdeset për zbatimin e akteve dhe përfundimeve të Kryesisë.

Neni 111

Kryesia e Republikës kryen punë nga kompetenca e vet në mbështetje dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjit dhe është përgjegjëse para qytetarëve të Republikës.

Kryetari dhe anëtarët e Kryesisë përgjigjen për shkeljen e Kushtetutës.

Përgjegjësinë e kryetarit ose të anëtarëve të Kryesisë së Republikës mundë ta inicojë më së paku dy të tretat e deputetëve ose Gjyqi Kushtetues i Kosovës.

3. QEVERIA E REPUBLIKËS

Neni 112

Qeveria e Republikës është organ i pushtetit ekzekutiv.

Neni 113

Qeveria e Republikës:

1. propozon dhe realizon politikën e Republikës dhe zbaton ligjet e dispozitat dhe aktet e tjera të Kuvendit të Republikës, në pajtim me Kushtetutën;
2. miraton dekretligje, vendime dhe dispozita të tjera për zbatimin e ligjeve;
3. propozon ligje, planin e zhvillimit, planin hapsinor, buxhetin dhe logarinë përfundimtare si dhe dispozita të tjera dhe akte të përgjithëshme;
4. orienton punën e ministrive dhe organeve të tjera të administratës;
5. bënë mbikqyrjen e punës së ministrive, abrogon ose anulon dispozitat e tyre që janë në kundërshtim me ligjin ose me dispozitat që i ka miratuar;
6. përcakton organizimin e brendshëm të ministrive; formon shërbime profesionale dhe shërbime të tjera për nevojat e veta, cakton dhe shkarkon funksionarët në ministri;
7. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Neni 114

Qeverinë e përbëjnë kryetari, nënkryetarët dhe ministrat.

Organizimi, mënyra e punës dhe vendosjes së Qeverisë rregullohet me ligj dhe me rregulloren e punës.

Neni 115

Kandidati për Kryetar të Qeverisë ia paraqet Kuvendit të Republikës programin e vet dhe propozon përbërjen e Qeverisë.

Qeveria konsiderohet e zgjedhur në qoftë se për zgjedhjen e saj voton shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve në Kuvend.

Pas konstituimit të Kuvendit të Republikës zgjedhet edhe Qeveria.

Kryetari, nënkryetarët dhe antarët e qeverisë gëzojnë imunitet sikurse deputetët.

Neni 116

Qeveria dhe çdo anëtar i saj për punën e vet i përgjigjen Kuvendit të Republikës.

Qeveria dhe çdo anëtar i saj mundë t'i paraqesin dorëheqje Kuvendit të Republikës.

Dorheqja ose shkarkimi nga detyra e kyetarit të Qeverisë tërheq dorheqjen e Qeverisë.

Kryetari i Qeverisë mund t'i propozojë Kuvendit të Republikës shkarkimin e disa ministrave të Qeverisë.

Kuvendi i Republikës mund të mos i japë votëbesim Qeverisë apo ndonjë anëtar i saj.

Propozimin për votimin e mosbesimit të Qeverisë mund ta paraqesin më së paku 30 deputetë.

Votimi për shkarkimin e Qeverisë mund të konsiderohet i miratuar, në qoftëse për këtë voton shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit.

Qeveria të cilës nuk i është dhënë votëbesimi, ose që ka paraqitur dorëheqje, mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.

Neni 117

Ministritë janë bartëse të funksioneve administrative.

Ministritë zbatojnë ligjet, dispozitat dhe aktet e tjera të Kuvendit republikan dhe të Qeverisë, si dhe aktet e Kryesisë së Republikës, vendosin për çështjet administrative, bëjnë mbikqyrjen administrative dhe të inspektimit dhe kryejnë punë të tjera administrative të përcaktuara me ligj.

Ministritë janë të pavarura në kryerjen e kompetencave të caktuara me Kushtetutë dhe ligj.

Punën e ministrisë e udhëheqë ministri.

Për punën e ministrisë, ministri i përgjigjet Kuvendit dhe Qeverisë.

Organizimi dhe kompetenca e ministrive përcaktohen me ligj.

4. GJYQET DHE PROKURORITË PUBLIKE

Neni 118

Funksionin gjyqësor e ushtrojnë gjyqet e rregullta si organe të pushtetit shtetëror.

Me ligj mund të themelohen edhe lloje të tjera të gjyqeve për zgjidhjen e kontesteve të caktuara.

Neni 119

Gjyqet e rregullta janë të pavarrura dhe gjykojnë vetëm në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 120

Shqyrtimi në gjyq është publik.

Për mbrojtjen e sekretit, mbrojtjen e moralit, interesave të të miturve ose mbrojtjen e interesave të tjera të përgjithshme, me ligj caktohet se në cilat raste në shqyrtim mund të përjashtohet opinioni.

Gjyqi punon në kolegji.

Me ligj mund të caktohet që disa çështje të gjykojë gjyqtari individual.

Neni 121

Në gjykim marrin pjesë gjyqtarët dhe gjyqtarët- qytetar, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Me ligj mund të përcaktohet se në disa gjyqe të caktuara dhe në disa çështje të caktuara të gjykojnë vetëm gjyqtarët.

Neni 122

Formimi, organizimi, kompetencat dhe përbërja e gjyqeve si dhe procedura para gjyqeve rregullohet me ligj.

Neni 123

Gjyqtarët e gjyqeve të rregullta zgjedhen dhe shkarkohen në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 124

Gjyqet themelohen si gjyqe të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë.

Gjyqi suprem i Kosovës është gjyqi më i lartë i Republikës.

Neni 125

Prokuroria publike është organ i pavarur shtetëror i cili ndjek kryesit e veprave penale dhe të veprave të tjera të caktuara të dënueshme sipas ligjit dhe parashtrohet mjete juridike për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë.

Prokuroria publike ushtron funksionin e vet vetëm në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

Formimi, organizimi dhe kompetencat e Prokurorisë publike rregullohen me ligj.

Neni 126

Funksioni, mënyra e zgjedhjes dhe e shkarkimit të prokurorit publik rregullohet me ligj.

Prokurori publik republikan kryen funksionin e Prokurorisë publike, në kuadër të të drejtave dhe të detyrave të Republikës në mënyrën e përcaktuar me ligj.

5. BANKA POPULLORE

Neni 127

Republika e ka Bankën Popullore.

Statusi, organizimi, qeverisja dhe veprimtaria e Bankës Popullore rregullohet me ligj.

6. GJYQI KUSHTETUES I KOSOVËS

Neni 128

Gjyqi Kushtetues i Kosovës.

1. vendos mbi pajtueshmërinë e ligjeve, dispozitave e akteve të tjera dhe statuteve të komunave e të qytetit me Kushtetutën;

2. vendos mbi pajtueshmërinë e dispozitave dhe të akteve të tjera të organeve republikane me ligjin;
3. vendos mbi pajtueshmërinë e të gjitha dispozitave dhe akteve të tjera me ligjin dhe dispozitën tjetër republikane;
4. vendos mbi pajtueshmërinë e statutit ose të aktit tjetër të partive politike, të lëvizjeve, të lidhjeve dhe të shoqatave me Kushtetutën përkatësisht mbi kundërshtinë me ligj;
5. vendos mbi ndalimin e punës së partive politike, të lëvizjeve, të lidhjeve dhe të shoqatave;
6. vendos mbi përgjegjësinë e kryetarit dhe të antarëve të Kryesisë së Republikës për shkelje të Kushtetutës;
7. zgjedh çështjet kontestuese të zgjedhjeve në qoftë se nuk janë në kompetencë të gjyqeve dhe të organeve tjera shtetërore;
8. kryen edhe punë të tjera që i janë lënë në kompetencë me Kushtetutë.

Gjyqi Kushtetues vlerëson kushtetutshmërinë e ligjeve dhe kushtetutshmërinë e ligjshmërinë e dispozitave e të akteve të tjera që kanë pushuar së vepruari, nëse nga pushimi i veprimit deri në fillimin e procedurës nuk ka kaluar më shumë se një vit.

Neni 129

Gjyqi Kushtetues përbëhet nga shtatë gjyqtarë.

Funksioni i gjyqtarit të Gjyqit Kushtetues zgjat tetë vjet dhe mundet përsëri të zgjidhet në të njëjtin funksion.

Kryetari i Gjyqit Kushtetues zgjedhet nga radhët e gjyqtarve për katër vjet dhe mund të zgjedhet edhe për një periudhë mandatore.

Gjyqtari i Gjyqit Kushtetues nuk mund të ushtrojë funksione të tjera me autorizime publike ose funksione profesionale.

Gjyqtari i Gjyqit Kushtetues gëzon imunitet sikurse deputetët në Kuvend.

Neni 130

Gjyqtari i Gjyqit Kushtetues shkarkohet sipas kërkesës së vetë, nëse dënohet për veprë penale me dënim heqje lirie, nëse humb përherë aftësinë e punës për të ushtruar funksionin e vet dhe kur t'i plotësojë kushtet për realizimin e të drejtës në pensionin e pleqërisë të përcaktuar me ligj.

Gjyqi Kushtetues e njofton Kuvendin mbi ekzistimin e shkaqeve për shkarkimin e gjyqtarit të Gjyqit Kushtetues.

Gjyqi Kushtetues mundë të vendosë që gjyqtari i Gjyqit Kushtetues kundët të cilit ka filluar procedura penale të mos ushtrojë detyrën deri sa të zgjasë kjo procedurë.

Neni 131

Secili mund të marrë inisiativë për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Procedurën para Gjyqit Kushtetues e fillojnë organet shtetërore.

Gjyqi Kushtetues mundet edhe vetë ta fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë e të ligjshmërisë.

Neni 132

Gjyqi Kushtetues vendos me shumicën e votave të anëtarëve të gjyqit.

Vendimet e Gjyqit Kushtetues janë të obligueshme dhe të ekzekutueshme.

Neni 133

Kur Gjyqi Kushtetues vërteton se ligji, dispozita ose akti tjetër i komunës e i qytetit nuk është në pajtim me Kushtetutën, ai ligj, dispozita ose akti tjetër ose statuti i komunës e i qytetit pushon së vepruari.

Kur Gjyqi Kushtetues vërteton se dispozita republikane, dispozita dhe akti tjetër nuk është në pajtim me ligjin, dispozita ose akti tjetër pushon së vepruari.

Neni 134

Procedura para Gjyqit Kushtetues dhe efekti juridik i vendimeve të tij rregullohen me ligj.

Organizimin e Gjyqit Kushtetues e rregullon Gjyqi Kushtetues me rregulloren e punës.

VIII. NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS

Neni 135

Propozimin për t'i hyrë ndryshimit të Kushtetutës mund ta paraqesin së paku 50.000 zgjedhës, më së paku 30 deputet të Kuvendit të Republikës, Kryesia e Republikës dhe Qeveria e Republikës.

Mbi propozimin për t'i hyrë ndryshimit të Kushtetutës vendos Kuvendi i Republikës me shumicën e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Propozimi për ndryshimin e Kushtetutës mund të ketë formën e amandamentit kushtetues, të ligjit kushtetues ose të Kushtetutës së re.

Neni 136

Projektaktin për ndryshimin e Kushtetutës e përcakton Kuvendi i Republikës dhe e nxjerr në diskutim publik.

Kuvendi, pas zbatimit të diskutimit publik, përcakton propozimin e aktit mbi ndryshimin e Kushtetutës dhe vendos mbi të.

Ndryshimi i Kushtetutës është i aprovuar në Kuvend nëse për të kanë votuar shumica nga numri i përgjithshëm i të gjithë deputetëve në Kuvend.

Në qoftë se ndryshimi i Kushtetutës nuk aprovohet, propozimi për ndryshimin e Kushtetutës për çështje të njëjtë nuk mund të përsëritet para se të kalojë një vit nga dita kur është rrefuzuar propozimi për ndryshimin e saj.

Në qoftë se Kuvendi nuk e aprovon propozimin për ndryshimin e Kushtetutës lidhur me atë çështje edhe pasi të kalojë një vit nga dita kur është rrefuzuar propozimi për ndryshimin e saj, propozimi për ndryshimin e Kushtetutës nxirret në referendum.

Neni 137

Akti mbi ndryshimin e Kushtetutës është i aprovuar në referendum nëse për të janë deklaruar më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve.

Në qoftë se akti mbi ndryshimin e Kushtetutës nuk miratohet as me referendum, propozimi i ri për ndryshimin e Kushtetutës për çështjen e njëjtë nuk mund të parashtrohet përsëri para se të kalojë një vit nga dita kur akti i tillë nuk është miratuar.

Ndryshimin e aprovuar të Kushtetutës e shpall Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 138

Mbi dhënien e pëlqimit për aktin më të lartë të bashkësisë së Jugosllavisë vendos Kuvendi i Republikës me shumicën prej dy të tretave të të gjithë deputetëve në Kuvend.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 139

Për zbatimin e kësaj Kushtetute dhe sigurimin e kalimit në aplikimin e saj do të nxirret Ligji i veçantë kushtetues.

Ligjin kushtetues e nxjerr Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Ligji kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Kosovës shpallet dhe hyn në fuqi njëkohsisht me Kushtetutën e Kosovës.

Neni 140

Kjo Kushtetutë hyn në fuqi ditën e shpalljes.

Kaçanik, 07. shtator 1990

KK. Nr. 1/90

REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI I REPUBLIKËS

**Në bazë të nenit 397 dhe 398 të Kushtetutës së Krahinës
Socialiste Autonome të Kosovës, Kuvendi i Kosovës në
mbledhjen e mbajtur më 7 shtator 1990, merr këtë**

V E N D I M

MBI SHPALLJEN E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Sh p a l l e t

**Kushtetuta e Republikës së Kosovës të cilën e
aprovoi Kuvendi i Kosovës në mbledhjen e mbajtur
më 7 shtator 1990.**

KK nr. 2/90 NËNKRYETARI I KUVENDIT
Kaçanik, 7 shtator 1990 Kryesuesi i mbledhjes

Ilaz Ramajli